



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.13, datë 28.02.2020

PËR
RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.16, DATË 27.04.2018,
PËR OBJEKTIN “NDËRTIMI I KOMPLEKSIT TURISTIK SAN PIETRO,
KOMUNA ISHËM, QARKU DURRËS”


Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Concord Investment” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.16, datë 27.04.2018, për objektin “Ndërtimi i kompleksit turistik San Pietro, Komuna Ishëm, Qarku Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Concord-Investment” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.16, datë 27.04.2018, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

